

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Akuzohen për falsifikim të dokumenteve dhe përfitim të padrejtë të pronave, dy ish-drejtorët e Kadastrës Fier mbeten në burg, një tjetër kalon në arrest shtëpie!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/akuzohen-per-falsifikim-te-dokumenteve-dhe-perfitim-t-e-padrejte-te-prona-i587136
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 17:07:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 18:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4f030401e1664fe80d372af4132654c2989e812a8296137df31c548312d0dd2a
TEKSTI	e91e56bb14893450a71aaab0a316a5fbcef7c300d0c0f02d42209993163c6b8d
PAMJA	c96d9f0bf4e033718f8678ab5a76390dec67f47f54169a1a0a71f3709912bdfa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2c2c71de4bd4040437c138de611991e3ca34389a54ea6884fb8fa64ff5192259
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2c2c71de4bd4040437c138de611991e3ca34389a54ea6884fb8fa64ff5192259>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Steka cigaresh kontrabande me autobus nga Shqipëria drejt Greqisë, procedohet shpëtimi, në 'lupe' edhe doganieret shqiptare që e janë të kalonte Serbia shtaq robote të arr fundit](#)

Akuzohen për falsifikim të dokumenteve dhe përfitim të padrejtë të pronave, dy ish-drejtorët e Kadastrës Fier mbeten në burg, një tjetër kalon në arrest shtëpie!



19 Shtator 2026, 20:15Kronika TEMA



Gjykata e Fierit ka vendosur të lërë në burg ish-drejtorin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Ertis Shehun, si dhe Pirro Çelën dhe Bardh Kapajn. Ndërkohë, për biznesmenin Kastriot Hasko, gjykata ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurisë me "arrest në shtëpi".

Vendimi është marrë në kuadër të hetimeve për procedimin përkatës. Personat ndaj të cilëve janë caktuar masat e sigurisë gëzojnë prezumimin e pafajësisë deri në një vendim të formës së prerë.

Siç kemi raportuar edhe më herët, këta shtetas dyshohen për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Mashtrimi", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Shpërdorimi i detyrës".

Hetimet ndaj tyre nisën pas dyshimeve për përfitim dhe regjistrim të kundërligjshëm të pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit, si dhe për tjetërsimin e tyre dhe qarkullimin e vlerave monetare të përfituara.

1. Vazhdimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim E.S., atë të "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

2. Vazhdimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim P.Ç., atë të "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

3. Vazhdimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim B.K., atë të "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

4. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal shtrëngues ndaj personit nën hetim K.H., nga masa e sigurimit "Arrest në burg" në atë të "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. Masë e cila do të vuhet nga personi nën hetim në banesën e tij

5. Urdhërohet personi nën hetim të mos largohet nga adresa e banimit dhe të mos ketë kontakte me persona të tjerë përveç pjesëtarëve të familjes.

6. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim K.H., nëse nuk mbahet apo nuk duhet të mbahet për efekt të ndonjë mase tjetër sigurimi apo vendimi dënimi.
7. Urdhërohet Policia Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore të mbikëqyrin dhe kontrollojnë zbatimin e vendimit të masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, nga personi nën hetim K.H.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Amnistia ngec nëpër sirtarë - Prokuroria vonon zbritjen e dënimit për 2868 persona në Shërbimin e Provës](#)

16:25 Kronika

[Shpërndanin kokainë me makinë në qytetin e Laçit, "Destinacioni" prangos 2 të rinjtë nga Tirana dhe Laçi!](#)

15:55 Kronika

[Detaje nga krimi në Tiranë: Burri e vrau gruan në sy të nipit 14 vjeç. Zbardhen emrat](#)

13:05 Kronika / 9 komente

Rregullorja censuruese e GJKKO, reagon OSBE: Kufizimet ndaj medias të kenë bazë të qartë ligjore dhe të jenë proporcionale!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.